

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjetjet e PISA/ Nxënësit shqiptarë kuriozë dhe të angazhuar, Kumbaro në panelin ministror të PISA: Dua m më shumë hapësira ku fëmijët mund të shkëlqejnë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/gjetjet-e-pisa-nxenesit-shqiptare-kurioze-dhe-te-angazhuar-kumbaro-ne-pa-i584892
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 08:10:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 08:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c1a57087ee02bcb8fa951edb61a8afb19da48f0f43fb75d74c07cbd1613bcb6e
TEKSTI	2b3a11ce4bf7361ad2a89adcbbee1aa12e5a5189bc98b1104555df23d728a34bd
PAMJA	fc5c5786ad5a9a67bc2a53fd5226e1827795ea9e2246d71a7b69fe705abbbdd08

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4861e489e7d1e1bbbb16ac2b7cc6554dced47d80cf6dc93c892438875ba1cbf7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4861e489e7d1e1bbbb16ac2b7cc6554dced47d80cf6dc93c892438875ba1cbf7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e Shperthimi te "Berryli", kreu i Sherbimit Zjarrfikes jep detaje: Flaket nisen nga rrjedhja e gazit , po hetohet nese ka patur defekt teknikIsh-kreu i NAIU-s apel partive ne Kosove: Vendosni interesi fundit

Gjetjet e PISA/ Nxënësit shqiptarë kuriozë dhe të angazhuar, Kumbaro në panelin ministror të PISA: Duam më shumë hapësira ku fëmijët mund të shkëlqejnë

9 Shtator 2026, 10:25Sociale TEMA



Gjetjet e PISA/ Nxënësit shqiptarë kuriozë dhe të

Rezultatet e PISA 2025 kanë sjellë një përmirësim të ndjeshëm të performancës së nxënësve shqiptarë në të tre fushat e vlerësimit, përkatësisht +65 pikë në matematikë, +59 pikë në shkencë dhe +50 pikë në lexim, duke e renditur Shqipërinë në nivelet më të larta të rajonit të Ballkanit Perëndimor në matematikë dhe shkencë. Rezultatet u prezantuan në Bratislavë, gjatë ministerialit të vendeve të OECD, ku Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro ishte e ftuar në një prej paneleve të diskutimit, së bashku me përfaqësues të vendeve të tjera, për të diskutuar mbi gjetjet e PISA 2025 dhe sfidat aktuale të arsimit.

Një prej temave të ngritura gjatë panelit ishte qëndrimi pozitiv i nxënësve shqiptarë ndaj të nxënët, ku të dhënat e PISA evidentojnë për nxënësit shqiptarë nivele të larta kurioziteti, këmbënguljeje përballë detyrave të vështira dhe bindjeje se arsimimi ia vlen.

E pyetur nga nënsekretari i Përgjithshëm i OECD František Ružička mbi këto gjetje, se si arrin sistemi arsimor shqiptar t'i kultivojë dhe t'i mbajë gjallë këto qëndrime pozitive të të rinjve ndaj të nxënët, ministrja Kumbaro u përgjigj: "A e shohin fëmijët shkollën vetëm si vendin ku marrin një notë, apo si vendin ku zbulojnë se në çfarë janë të zotët?" Sipas saj, reforma kurrikulare e cila do të vijojë deri në vitin 2029, synon ta lidhë më fort të nxënët me botën ku jetojnë fëmijët, ndërsa aktivitetet jashtë kurrikulës u japin nxënësve më shumë mundësi për të zbuluar aftësitë e tyre. Kjo shkon krah për krah me gjithë aktivitetet që organizon Ministria e Arsimit për nxënësit. Kumbaro përmendi Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe, Festivalin e Shkencës, olimpiadat kombëtare dhe investimin në sport, ku aktualisht rreth 11 mijë fëmijë janë përfshirë në ekipet e volejbollit dhe basketbollit.

"Duam të krijojmë më shumë hapësira ku fëmijët mund të kenë sukses", u shpreh Kumbaro, duke shtuar se një fëmijë mund të mos jetë më i miri në matematikë, por mund të shkëlqejë në art, sport, gjuhë apo teknologji. "Ne duam që çdo fëmijë të ketë të paktën një moment në shkollë kur të mund të thotë: 'Kjo është aftësia ime dhe unë jam i zoti në këtë fushë', tha ministrja.

Një tjetër diskutim i panelit u përqendrua te balanca mes përfitimeve dhe rreziqeve të teknologjisë digjitale në klasë. Sipas gjetjeve të raportit të OECD, Nënsekretari i Përgjithshëm i OECD Ružička tha se nxënësit shqiptarë kanë treguar nivele të ulëta shpërqendrimi nga teknologjia. Ministria Kumbaro e argumentoi përgjigjen duke theksuar se përpara rregullave duhet folur për kulturën dhe mënyrën se si teknologjia përdoret në familje e në shoqëri. Ajo theksoi se teknologjia nuk mund të qëndrojë jashtë shkollës, duke përmendur ndalimin e përdorimit të celularëve në shkolla për të dytin vit radhazi, por edhe investimin në teknologjinë për të nxënët, me objektivin për të arritur në 1,000 Smart Labs deri në vitin 2029. Në këtë kontekst, ministrja prezantoi edhe zgjerimin e programit "Pas Shkollë" në 408 shkolla në të gjithë vendin, me aktivitete të dedikuara në art, muzikë, teatër, sport dhe klube të ndryshme, me synimin që fëmijët të kalojnë më shumë kohë cilësore në shkollë dhe të kenë më shumë hapësira për të zbuluar interesat e tyre.

"Pyetja nuk është më nëse fëmijët do ta përdorin teknologjinë. Ata do ta përdorin. Pyetja e vërtetë është se kush do t'u mësojë ta përdorin mirë? Dhe këtë po përpiqemi të bëjmë, t'u japim fëmijëve, por edhe mësuesve instrumentet e duhura për ta përdorur mirë teknologjinë", u shpreh Kumbaro.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

[Rama për rezultatet e PISA-s: Shqipëria mori një “dëftesë të jashtëzakonshme”, rezultati më i mirë ndonjëherë](#)

08:45 Sociale / 10 komente

[Grant Performance, ministri Demo: 2.5 milionë euro për bashkitë që ofrojnë shërbime më të mira](#)

20:20 Sociale / 4 komente

[Kadastra shkon derë më derë, nis nga Palasa trajtimin e banesave pa dokumentacion pronësie](#)

18:57 Sociale / 2 komente

[Parkim nëntokësor te sheshi “Nënë Tereza” - Tenderi 21 mln euro, 170 vende e muze arkeologjik. Trafiku i automjeteve zhvendoset nën tokë](#)

14:00 Sociale / 9 komente

[Nis rikualifikimi pranë tregut të orizit në Vlorë, shemben objektet pa leje](#)

12:40 Sociale / 5 komente

[PISA 2025, Shqipëria ngjitet në renditje, Kumbaro: Kryesojmë Ballkanin Perëndimor në matematikë dhe shkencë \(VIDEO\)](#)

12:35 Sociale / 26 komente

[Shkelje në menaxhimin e mbetjeve, IKMT pezullon aktivitetin e kompanisë private dhe e gjobit!](#)

11:50 Sociale

[Protestë para Bankers Petroleum, banorët kërkojnë pagesat për tokat: Nëse nuk na dëgjojnë do të bllokojmë pusët e naft](#)

11:40 Sociale / 4 komente

[Tirana mirëpret konferencën Diaspora4Innovation](#)

11:02 Sociale

[Transporti publik/ 116 subjekte përfitojnë rreth 120 milionë lekë kompensim](#)

10:50 Sociale

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...

14:15 Politika / 51 komente

Përplasja mes biznesmenëve për pronën në Palasë, Filip Ç...

10:10 Sociale / 26 komente

FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...

17:35 Politika / 106 komente

Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...

14:50 Politika / 10 komente

Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...

19:40 Politika / 107 komente

Blog Tema

Një debat që nuk duhet të mbarojë te telefonat

09:45 Blog

25-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit: Maqedoni, mars-gusht 2001

09:15 Blog

“Respekte”, z. Korrupsion!

22:30 Blog / 8 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

REGJISTROHU

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Built and Monetized by